



**Pyetjet më të shpeshta për
licencimin e
ndërmjetësuesve në
sigurime**

Përmbajtja

Pyetjet më të shpeshta për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime.....	5
Të përgjithshme.....	5
1. Kush është BQK?	5
2. Çfarë janë institucionet financiare?.....	5
3. Çfarë do të thotë ndërmjetësim në sigurime?	5
4. Çfarë do të thotë ndërmjetësues në sigurime?.....	5
5. Çfarë do të thotë degë e kompanisë së jashtme ndërmjetësuese?.....	6
6. Çka do të thotë kompani ndërmjetësuese në sigurime?.....	6
7. Çka do të thotë agjent i sigurimeve?	6
8. Çka do të thotë kompani e agjentëve?.....	6
9. Çka do të thotë broker i sigurimeve?	6
10. Çka do të thotë kompani e brokerimit?	6
11. Kur mund ta quaj veten ndërmjetësues në sigurime?.....	6
12. A mund të ketë kompania ndërmjetësuese në sigurime statut tjetër përveç shoqërisë aksionare?	7
13. Çfarë statutit mund të ketë ndërmjetësuesi fizik në sigurime?.....	7
14. Çfarë është licenca?	7
15. Çfarë veprimtari financiar janë të lejuara për ndërmjetësuesit në sigurime në Kosovë?.....	Error! Bookmark not defined.
16. Kush mund ta ushtrojë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime?.....	7
17. Ku duhet të aplikojë për t'u pajisur me licencë për ndërmjetësues në sigurime?.....	7
18. A ka rëndësi nëse unë nuk jam me qendër në Kosovë?	7
19. Sa ndërmjetësues në sigurime janë të licencuar në Kosovë?	7
20. Kush duhet të jetë prezentë në takimin informues nga ana e aplikuesit?.....	7
21. Në takimin informues a mund të marrin pjesë vetëm përfaqësuesit e aksionarëve?.....	8
22. Cilët janë aksionarët kryesor të ndërmjetësuesit në sigurime?	8
23. Çfarë duhet të përgatitni për takimin informues?	8
24. Kur mund të fillojë të përgatisë aplikacionin për licencim si ndërmjetësues në sigurime?.....	8
25. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzojë si aplikacion për licencim si ndërmjetësues në sigurime?	8
26. Sa shpejt mund të bëhem ndërmjetësues në sigurime?.....	8
Para aplikimit.....	9
27. A duhet të kaloj nëpër procesin e para-aplikimit?.....	9

28.	<i>Çka është plani i biznesit?</i>	9
29.	<i>A janë ndërveprimet e mia me ju konfidenciale?</i>	9
30.	<i>Sa është kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një ndërmjetësuesi të ri në sigurime?</i>	9
31.	<i>A aplikohet kërkesa për kapital edhe me rastin e hapjes së një dege të ndërmjetësuesve të jashtëm (huaj) në sigurime në Kosovë?</i> 10	
32.	<i>Kush mund të jetë aksionar i ndërmjetësuesit në sigurime?</i>	10
33.	<i>Çfarë prejardhje mund të kenë fondet për investim në formë të kapitalit?</i>	10
34.	<i>A mund të lëshojmë aksione në këmbim të shërbimeve?</i>	10
35.	<i>Sa anëtar mund të ketë bordi i drejtorëve të një ndërmjetësuesi në sigurime?</i>	10
36.	<i>A munden aksionarët të jenë anëtarë të bordit të drejtorëve?</i>	10
37.	<i>Cilët drejtorë mund të konsiderohen joekzekutiv?</i>	Error! Bookmark not defined.
38.	<i>A mundet kryeshefi ekzekutiv të jetë anëtar i bordit të drejtorëve?</i>	11
39.	<i>Çfarë do të thotë i përshtatshëm dhe i duhur për drejtorët dhe menaxherët e lartë?</i>	11
40.	<i>Kur, ku dhe si duhet ta dorëzojë aplikacionin për licencë ndërmjetësuesi në sigurime?</i>	11
41.	<i>Ku mund të lexoj më shumë për qasjen e BQK-së për licencimin e ndërmjetësuesve të jashtëm në sigurime?</i>	11
42.	<i>A kam nevojë të punësoj këshilltarë ose konsulentë të jashtëm?</i>	11
43.	<i>A mund të rekomandoni ndonjë këshilltar ose konsulent të jashtëm?</i>	11
44.	<i>A mund t'i sjell këshilltarët e mi në takimet me ju?</i>	11
45.	<i>A mund të përdor ofruesit e shërbimeve të kontraktuara?</i>	11
46.	<i>A specifikoni cilat sisteme të TI duhet të përdorni?</i>	12
47.	<i>A mund të rekomandoni ndonjë sistem / ofrues të TI-së?</i>	12
48.	<i>Çfarë duhet të bëjë nëse në ndërkohë gjatë aplikimit gjërat ndryshojnë?</i>	12
49.	<i>Sa është tarifa e licencimit për ndërmjetësuesit në sigurime</i>	12
50.	<i>Ku mund të gjej detajet e tarifave të aplikimit?</i>	12
51.	<i>Pse duhet të paguaj një tarifë?</i>	12
	Pas aplikimit	12
52.	<i>Çfarë ndodhë pas aplikimit në BQK për licencë të ndërmjetësuesit në sigurime?</i>	12
53.	<i>Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim të kompanive ndërmjetësuese, degëve të ndërmjetësuesve të jashtëm, aktivitetit shtesë të ndërmjetësimit?</i>	13
54.	<i>Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim të ndërmjetësuesve individual (persona fizik)?</i>	13
55.	<i>Cilat kushte duhet të plotësojë në mënyrë që aplikacioni im për licencë të miratohet në BQK?</i>	13
56.	<i>A duhet të plotësoj të gjitha kriteret e licencimit?</i>	13

57.	<i>A ka ndonjë kusht tjetër që merret parasysh nga BQK si kriter për licencim në BQK?</i>	Error! Bookmark not defined.
Licencimi	14
58.	<i>Çfarë ndodhë nëse ndonjëra nga informatat e dorëzuara me aplikacion ndryshon gjatë periudhës së vlerësimit të aplikacionit tim në BQK?.....</i>	14
59.	<i>Çfarë do të thotë Ekzaminimi i parahapjes?.....</i>	14
60.	<i>A mund të refuzohet aplikimi im?.....</i>	14
61.	<i>A mund të apeloj nëse refuzohet kërkesa ime?.....</i>	14
62.	<i>A mund të filloj aktivitetet e organizmit para se të licencohem?.....</i>	14
Ndërmjetësuesit e jashtëm (huaj)	14
63.	<i>Cili është dallimi në mes të një filiali dhe një dege?</i>	14

Pyetjet më të shpeshta për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime

Pyetjet më të shpeshta që BQK pranon nga të interesuarit për aplikim për licencim të ndërmjetësuesve në sigurime janë organizuar në kategoritë e mëposhtme:

- Të përgjithshme;
- Para aplikimit;
- Pas aplikimit;
- Miratimi paraprak;
- Licencimi;
- Ndërmjetësuesit jashtëm (huaj).
-

Të përgjithshme

1. *Kush është BQK?*

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është një institucion publik i pavarur, objektivi parësor i së cilës është nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar si dhe një sistemi efikas të pagesave. Është autoriteti i vetëm për licencim, rregullim dhe mbikëqyrje të institucioneve financiare në Kosovë. Përgjegjësitë dhe objektivat e BQK-së janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (linku <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Ligji%20per%20BQK-ne.pdf>, më tutje ligji për BQK) si dhe Ligjin Nr. 05/L-045 për Sigurimet (linku http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Ligji%20Nr.%2005%20L-045%20per%20Sigurimet.pdf më tutje ligji për sigurimet).

2. *Çfarë janë institucionet financiare?*

Institucione Financiare nënkupton subjektet si: banka, kompani të sigurimeve, fonde pensionale, institucione mikrofinanciare, institucione financiare jobankare, ndërmjetësues në sigurime, trajtues të dëmeve si dhe subjekte tjera juridike që ushtrojnë aktivitete financiare siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi dhe sipas të cilit Bankës Qendrore i është dhënë autoritet për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e tyre.

3. *Çfarë do të thotë ndërmjetësim në sigurime?*

Ndërmjetësim në sigurime nënkupton veprimtarinë e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënies së asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi.

4. *Çfarë do të thotë ndërmjetësues në sigurime?*

Ndërmjetësues në sigurime nënkupton personin fizik apo juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguroesi, për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime.

5. *Çfarë do të thotë degë e kompanisë së jashtme ndërmjetësuese?*

Degë e kompanisë së jashtme ndërmjetësuese nënkupton degën ligjrisht të varur të kompanisë së agentëve ose kompanisë së brokerëve, e cila kompani ka selinë kryesore në ndonjë vend të jashtëm, dhe është licencuar për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në republikën e Kosovës.

6. *Çka do të thotë kompani ndërmjetësuese në sigurime?*

Kompani ndërmjetësuese në sigurime nënkupton kompaninë e agentëve dhe kompaninë e brokerimit.

7. *Çka do të thotë agjent i sigurimeve?*

Agjent i sigurimeve nënkupton personin fizik, i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguroesi sipas një kontrate ndërmjetësimi për të zhvilluar veprimtari ndërmjetësimi në sigurime në llogari të siguroesve. Përveç kësaj, agjent i sigurimeve konsiderohet edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e agentëve, bankën ose agjencionin e udhëtimit të licencuar për veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, për të vepruar në llogari të siguroesve.

8. *Çka do të thotë kompani e agentëve?*

Kompani e agentëve nënkupton personin juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga një ose me shumë siguroes, që të zhvillojë aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime, në llogari të siguroesit.

9. *Çka do të thotë broker i sigurimeve?*

Broker i sigurimeve nënkupton personin fizik, i licencuar nga BQK-ja që të zhvillojë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime dhe që vepron në llogari të të siguroarve. Brokeri ndërmjetëson në mes të të siguroarve dhe një ose më shumë siguroesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale. Përveç kësaj, broker i sigurimeve konsiderohen edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e brokerimit ose bankën e licencuar për aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime.

10. *Çka do të thotë kompani e brokerimit?*

Kompani e brokerimit nënkupton personin juridik i licencuar nga BQK-ja që të zhvillojë veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime dhe që vepron në llogari të të siguroarve. Kompania e brokerimit ndërmjetëson në mes të të siguroarve dhe një ose më shumë siguroesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale.

11. *Kur mund ta quaj veten ndërmjetësues në sigurime?*

Asnjë person nuk mund të përdorë fjalën “sigurim”, “risigurim”, “ndërmjetësues në sigurime” “trajtues i dëmeve” ose derivatet e këtyre fjalëve në lidhje me një veprimtari, produkt ose shërbim ose në veprimtari promicionale pa pasur një licencë të lëshuar nga BQK-ja, për t’u përfshirë në aktivitetin e sigurimeve, përveç kur një përdorim i tillë është vendosur ose njohur me këtë ligj. Asnjë zyre përfaqësuese nuk mund të përdorë fjalën “sigurim” në emrat e tyre, përveç rasteve kur fjala “sigurim” formon një pjesë integrale të emrit të ndërmjetësuesit të jashtëm të cilit ato i përkasin me kusht që, në raste të tilla të shtohet fjala “zyra përfaqësuese”.

12. A mund të ketë kompania ndërmjetësuese në sigurime statut tjetër përveç shoqërisë aksionare?

Po, çdo kompani ndërmjetësuese në sigurime që aplikon për licencim në BQK duhet të jetë i regjistruar si Shoqëri Aksionare apo Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas statutit vetanak bazuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Në rastet kur aplikohet si degë e kompanisë së ndërmjetësuesit të jashtëm, kompania ndërmjetësuese amë është përcaktuese e statutit të entitetit ligjor.

13. Çfarë statutit mund të ketë ndërmjetësuesi fizik në sigurime?

Ndërmjetësuesi fizik në sigurime duhet të jetë i regjistruar si Biznes Individual sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

14. Çfarë është licenca?

Licencë është autorizim i lëshuar nga BQK-ja për dhënien e të drejtës për tu marrë me veprimtaritë e specifikuar sipas atij autorizimi.

15. Kush mund ta ushtrojë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime?

Veprimtaria e ushtrimit në sigurime mund të ushtrohet nga agjentët e sigurimeve, kompanitë e agjentëve, brokerët e sigurimeve dhe kompanitë e brokerimit. Po ashtu, veprimtaria e ndërmjetësimit mund të ushtrohet edhe nga bankat që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Kosovës pasi ato të licencohen nga BQK-ja si dhe nga agjencionet e udhëtimit vetëm sa i përket produktit të sigurimit të shëndetit në udhëtim.

16. Ku duhet të aplikojë për t'u pajisur me licencë për ndërmjetësues në sigurime?

Për t'u pajisur me licencë për ndërmjetësues në sigurime në Republikën e Kosovës, ju duhet të kontaktoni Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit, përmes emailit (Licencimi@bqk-kos.org) apo telefonit (+381 38 222 055), ku do të merreni udhëzimet e nevojshme për aplikim. Aty do të informoheni edhe se, para se të filloni me procesin e aplikimit është e obliguar mbajtja e takimit informues me përfaqësuesit e BQK-së.

17. A ka rëndësi nëse unë nuk jam me qendër në Kosovë?

BQK i mirëpret kërkesat nga çdo ndërmjetësues në sigurime të ri me një model biznesi të shëndoshë pavarësisht se ku kanë institucionin “mëmë” të themeluar. Nëse ju jeni një ndërmjetësues në sigurime me seli në mbarë botën ju mund të veproni në Kosovë si një filiale ose degë (ose të dyja) - ju lutemi shikoni të dhënat e Shtojca IV – Ndërmjetësuesit e jashtëm (huaj) në Manualin e Licencimit të Ndërmjetësuesve në Sigurime.

18. Sa ndërmjetësues në sigurime janë të licencuar në Kosovë?

Ndërmjetësuesit në sigurime të licencuar në Republikën e Kosovës mund t'i gjeni në web faqen e BQK-së në.

19. Kush duhet të jetë prezentë në takimin informues nga ana e aplikuesit?

Në takim duhet që të marrin pjesë të gjithë aksionarët kryesor/themeluesit të ndërmjetësuesit të ri të propozuar.

20. Në takimin informues a mund të marrin pjesë vetëm përfaqësuesit e aksionarëve?

Jo, në takim duhet të jenë prezent të gjithë aksionarët/themeluesit kryesor të ndërmjetësuesit të ri të propozuar.

21. Cilët janë aksionarët kryesor të ndërmjetësuesit në sigurime?

Aksionar kryesor nënkupton posedimin direkt apo indirekt në një subjekt, i cili përfaqëson dhjetë përqind (10%) ose më shumë të aksioneve me të drejtë vote.

22. Çfarë duhet të përgatitni për takimin informues?

Para mbajtjes së takimit informues të interesuarit për aplikim duhet të përgatiten për të prezantuar në takim një përmbledhje të shkurtër të nivelit të lartë të propozimit të biznesit, që si minimum duhet të përmbajë:

- arsyeshmërinë e themelimit të ndërmjetësuesit në sigurime si dhe strategjinë fillestare të biznesit duke specifikuar se cilat produkte do të ofrohen, si do t'i ofrohen ato dhe tregun e synuar;
- burimet e financimit - si do të financohen dhe nëse kanë ndonjë investitor dhe/ose fonde në vend;
- pronësinë dhe ekipin menaxherial - detajet e pronarëve dhe menaxherëve të propozuar, për aq sa ato njihen;
- planin kohor- një pasqyrë dhe afat kohor të planit për të themeluar ndërmjetësuesin e ri në sigurime.

23. Kur mund të fillojë të përgatisë aplikacionin për licencim si ndërmjetësues në sigurime?

Pas mbajtjes së takimit informues dhe dërgimit të formave për aplikim nga BQK, ju mund të filloni përgatitjen e aplikacionit për licencim si ndërmjetësues në sigurime në BQK.

24. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzohë si aplikacion për licencim si ndërmjetësues në sigurime?

Aplikacioni për licencim si ndërmjetësues në sigurime duhet të shoqërohet nga informacionet e kërkuara në me Rregullore për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.

25. Sa shpejt mund të bëhem ndërmjetësues në sigurime?

Nuk ka përgjigje të thjeshtë për këtë pyetje. Faza e para-aplikimit nuk ka një afat kohor të përcaktuar dhe shpejtësia e përparimit është tërësisht në vete. BQK është e interesuar për cilësinë e materialit që ju përgatitni më tepër sesa sasinë ose shpejtësinë në të cilën ju përgatiteni. Pasi të kenë paraqitur kërkesën tuaj, do të aplikojë një afat ligjor prej nëntëdhjetë (90) ditësh për të arritur një vendim për aplikimin tuaj - ju lutemi shihni fazën e Aplikimit në Manualin për Licencimin të Ndërmjetësuesve në Sigurime për më shumë detaje.

Para aplikimit

26. A duhet të kaloj nëpër procesin e para-aplikimit?

Po, ju duhet që të ndiqni procesin e para-aplikimit, kjo është kërkesë formale e BQK-së. Keni parasysh që firmat/ individët që janë më proaktive në fazën e para-aplikimit, paraqesin një kërkesë shumë më cilësore që BQK mund ta vlerësoj më lehtë.

27. Çka është plani i biznesit?

Plani i biznesi është një përshkrim i biznesit tuaj të propozuar, që përmban detajet e objektivave tuaja dhe si do t'i arrini ato. Plani juaj i biznesit duhet të përshtatet me aktivitetet që firma juaj ka në plan të ndërmarrë duke marrë parasysh edhe kriteret e licencimit të BQK-së. Plani i biznesit, për të qenë i pranueshëm nga BQK, duhet minimalisht të përmbajë informatat e mëposhtme:

- pasqyrën e biznesit: strategjinë e përgjithshme të ndërmjetësuesit të propozuar dhe detajet mbi veprimtarinë e planifikuar të ndërmjetësuesit në sigurime;
- analizën e tregut duke përfshirë analizën e konkurrencës direkte dhe indirekte;
- analizën financiare ku përfshihet shpalosja e strukturës së asetëve, detyrimeve dhe kapitalit si dhe projeksionet financiare për tre (3) vitet e para të operimit, si dhe programin e planifikuar për ndërmjetësim në sigurime;
- funksionet e rëndësishme të ndërmjetësuesit në sigurime;
- strukturën udhëheqëse të ndërmjetësuesit në sigurime.

Nëse paraqitni një plan biznesi të paplotë ose të paqartë, kjo do të shkaktojë vonesa në vlerësimin e aplikacionit tuaj, pasi BQK do të duhet të bëj pyetje të mëtejshme ose të kërkoj informacione të mëtejshme për të fituar një pasqyrë të qartë të biznesit tuaj. Megjithatë, plani juaj i biznesit edhe mund të evoluojë gjatë procesit të para-aplikimit, përderisa zhvillon modelin tuaj të biznesit dhe merrni komentet nga BQK. Plani i Biznesit është një pjesë e rëndësishme e aplikimit tuaj të përgjithshëm dhe është pjesë përbërëse e vendimmarrjes së BQK-së. BQK do ta përdor atë për të vlerësuar rreziqet që biznesi juaj i paraqet për objektivat tuaja dhe se si planifikoni t'i kontrolloni dhe menaxhoni ato. Ju gjithashtu duhet të përdorni planin tuaj të biznesit për t'ju ndihmuar të fokusoheni në drejtimin e aktiviteteve tuaja dhe organizimin e burimeve për të arritur objektivin tuaj.

28. A janë ndërveprimet e mia me ju konfidenciale?

Po. Të gjitha pyetjet dhe informatat që BQK pranon do të trajtohen si konfidenciale.

29. Sa është kapitali minimal i kërkuar për hapjen e një ndërmjetësuesi të ri në sigurime?

Për të ushtruar veprimtari ndërmjetësuese në Republikën e Kosovës një kompani ndërmjetësuese apo dega e një ndërmjetësuesi të jashtëm, varësisht nëse aplikon si kompani e agjentëve apo kompani e brokerimit duhet të zotojnë kapital fillestar minimal në shumë prej pesë mijë (5,000) Euro nëse themelohet si kompani të agjentëve dhe dhjetë mijë (10,000) Euro nëse themelohet si kompani të brokerimit. Në rastet e degëve të

kompanive të jashtme ndërmjetësuese duhet te zotojnë kapital në vlerë prej pesë mijë (5,000) Euro respektivisht dhjetë mijë (10,000) Euro si Fond Garantues, i cili do të mirëmbahet në çdo kohë.

30. A aplikohet kërkesa për kapital edhe me rastin e hapjes së një dege të ndërmjetësuesve të jashtëm (huaj) në sigurime në Kosovë?

Po, të njëjtat kërkesa për kapital vlejnë edhe për degë të ndërmjetësuesve të jashtëm (huaj) në sigurime.

31. Kush mund të jetë aksionar i ndërmjetësuesit në sigurime?

Aksionar i ndërmjetësuesit në sigurime mund të jetë çdo person i cili është i përshtatshëm dhe vërteton qëndrueshmërinë financiare.

32. Çfarë prejardhje mund të kenë fondet për investim në formë të kapitalit?

Kapitali themeltar duhet të paguhet në para të gatshme dhe nuk mund të rrjedhin nga fondet e marra hua nga publiku, kredi bankare si dhe fonde të tjera, origjina e të cilave është e paligjshme.

Për të vërtetuar burimin e parave për kapitalin themeltar dhe shtesën e këtij kapitali në BQK, dorëzohet dokumentacioni i mëposhtëm:

- për personat juridikë:
 - o evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, si raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të ndërmjetësuesit;
 - o vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.
- për personat fizikë:
 - o evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;
 - o vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore.

Nëse prejardhja e kapitalit themeltar nuk është e qartë për BQK-në, kjo përbën bazë për refuzim të licencës.

33. A mund të lëshojmë aksione në këmbim të shërbimeve?

Aksionet e lëshuara në këmbim të shërbimeve nuk trajtohen si kapital minimal i kërkuar. Gjithashtu edhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose për qiramarrjen e lokaleve të punës dhe pajisjeve, si dhe shpenzimet e tjera operative nuk përfshihen në shumën e kapitalit minimal të kërkuar.

34. Sa anëtar mund të ketë bordi i drejtorëve të një ndërmjetësuesi në sigurime?

Bordi i drejtorëve (nëse është e aplikueshme) duhet ta këtë përbërjen sikurse përcaktohet me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në fuqi dhe statutin e kompanisë ndërmjetësuese.

35. A munden aksionarët të jenë anëtarë të bordit të drejtorëve?

Po munden, nëse lejohet me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

36. *A mundet kryeshefi ekzekutiv të jetë anëtar i bordit të drejtorëve?*

Kryeshefi Ekzekutiv mund të jete është anëtar i bordit të drejtorëve, përveç nëse një gjë e tillë kufizohet me legjislacionin për shoqëritë tregtare në fuqi.

37. *Çfarë do të thotë i përshtatshëm dhe i duhur për drejtorët dhe menaxherët e lartë?*

Përshtatshmëria e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të propozuar konsiderohet si thelbësore në procesin e BQK-së për licencimin dhe mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve në sigurime. Elementet të cilat merren në konsideratë për këto kritere përfshijnë: të dhënat mbi veprat penale, pozitën financiare, veprimet civile kundër individëve për ndjekjen e borxhit personal, refuzimi i anëtarësimit apo përjashtimi nga organizatat profesionale, sanksione të zbatuara nga rregullatorët e industrive të ngjashme dhe praktikrat e mëhershme të dyshimta të biznesit, kualifikimi arsimor si dhe përvoja. Çdo aksionar kryesor, drejtor dhe menaxher i lartë duhet të përmbushin kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur, në lidhje me pozicionin përkatës

38. *Kur, ku dhe si duhet ta dorëzojë aplikacionin për licencë ndërmjetësuesi në sigurime?*

Aplikacionin duhet ta dorëzoni, pasi që të keni plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, në BQK në formë fizike dhe elektronike.

39. *Ku mund të lexoj më shumë për qasjen e BQK-së për licencimin e ndërmjetësuesve të jashtëm në sigurime?*

Për procesin e licencimit të ndërmjetësuesve në sigurime ju mund të lexoni në Ligjin NR. 05/L -045 për sigurimet (linku http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Ligji%20Nr.%2005%20L-045%20per%20Sigurimet.pdf); rregulloren për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime (linku: http://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Finale-%20Rregullore%20per%20Licencimin%20e%20Ndermjetesuesve%20ne%20Sigurime.pdf).

40. *A kam nevojë të punësoj këshilltarë ose konsulentë të jashtëm?*

Kjo varet vetëm nga ju, por BQK nuk kërkon nga ju që ta bëni këtë. Shumë aplikues e vlerësojnë të dobishme angazhimin e këshilltarëve të jashtëm ose konsulentë, ndërsa të tjerët vlerësojnë se kanë nivelin e duhur të ekspertizës brenda stafit të tyre.

41. *A mund të rekomandoni ndonjë këshilltar ose konsulent të jashtëm?*

Jo, BQK nuk mund të rekomandoj ndonjë këshilltarë të veçantë të jashtëm ose konsulentë.

42. *A mund t'i sjell këshilltarët e mi në takimet me ju?*

Po ju mund t'i sjellni, por BQK nuk pret që ata të flasin në emrin tuaj.

43. *A mund të përdor ofruesit e shërbimeve të kontraktuara?*

Po, me disa përjashtime. Por një gjë duhet të keni parasysh që ju si biznes mbani përgjegjësinë e plotë për të përmbushur përgjegjësitë tuaja ligjore pa marrë parasysh nëse është funksion i deleguar apo jo.

44. A specifikoni cilat sisteme të TI duhet të përdorni?

BQK nuk specifikon cilat sisteme të TI duhet të përdorni. Aktivitetet e rregulluara të firmës suaj duhet të mbështeten nga shërbimet e TI-së të cilat janë efektive dhe të sigurta si dhe janë të dizajnuara në mënyrë të përshtatshme për të plotësuar nevojat e ardhshme të pritshme, si dhe nevojat aktuale të biznesit.

45. A mund të rekomandoni ndonjë sistem / ofrues të TI-së?

Jo, BQK nuk mund të rekomandoj ndonjë sistem/ofrues të TI-së.

46. Çfarë duhet të bëj nëse në ndërkohë gjatë aplikimit gjërat ndryshojnë?

Nëse ka ndonjë ndryshim në lidhje me planet tuaja duhet të kontaktoni BQK-në më së largu pesë (5) ditë nga data e ndryshimit dhe të diskutoni për këto ndryshime.

47. Sa është tarifa e licencimit për ndërmjetësuesit në sigurime

Tarifa e licencimit për ndërmjetësues individual në sigurime agjent apo broker është pesëqind (500) EUR; Tarifa e licencimit për kompani të agjentëve si ndërmjetësues në sigurime është tre mijë (3,000) EUR dhe tarifa e licencimit për kompani të brokerimit si ndërmjetësues në sigurime është pesë mijë (5,000) EUR.

48. Ku mund të gjej detajet e tarifave të aplikimit?

Të gjitha tarifat e kërkuara të aplikimit janë të paraqitura në Skemën e Tarifave që gjendet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së (<http://bqk-kos.org/?id=88>) dhe janë të pakompensueshme, pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen, nëse tarifa e licencimit nuk është paguar.

49. Pse duhet të paguaj një tarifë?

BQK financohet nga tarifat dhe taksat që duhet të paguhen nga subjektet që i licencen, rregullon dhe mbikëqyr. Si pjesë e kësaj BQK kërkon një tarifë për shqyrtimin e një aplikimi për të licencuar një ndërmjetësues.

Pas aplikimit

50. Çfarë ndodhë pas aplikimit në BQK për licencë të ndërmjetësuesit në sigurime?

Pas dorëzimit formal të aplikacionit për licencim të ndërmjetësuesit në sigurime, BQK bën vlerësimin e parë ku verifikohet nëse aplikacioni i dorëzuar është i plotë ose jo. Që aplikacioni të vlerësohet i plotë, duhet të dorëzohen në BQK të gjitha format e kërkuara, të cilat duhet të jenë plotësuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte dhe informacioni i ofruar duhet të jetë i cilësisë dhe detajeve të mjaftueshme për të lejuar BQK-së përfundimin e vlerësimin. Gjithashtu që të vlerësohet i plotë aplikacioni, duhet t'i ketë të inkuorporuara përgjigjet ndaj komenteve të BQK-së të ofruara gjatë fazës së para-aplikimit.

51. Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim të kompanive ndërmjetësuese, degëve të ndërmjetësuesve të jashtëm, aktivitetit shtesë të ndërmjetësimit?

BQK-ja brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Sigurime ose Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, BQK-ja do të njoftojë aplikuesin për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e Ligjit për Sigurime ose kësaj Rregullore, së bashku me kërkesën për informata ose dokumente shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave ose dokumenteve shtesë është jo me vonë se nëntëdhjetë (90) pas njoftimit. Nëse informatat ose dokumentet shtesë të kërkuara janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për licencim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës së njoftimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për licencim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin. BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon licencimin e kompanisë ndërmjetësuese në sigurime, degëve të kompanive ndërmjetësuese të jashtme si dhe bankave dhe agjensioneve të udhëtimit, që kanë aplikuar tu licencuar për veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime, brenda tre (3) muajve nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për licencim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme. Kërkesa për informata shtesë sqaruese në këtë fazë nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës prej nëntëdhjetë (90) ditësh për të vendosur rreth kërkesës për licencim.

52. Sa zgjatë vlerësimi i aplikacionit për licencim të ndërmjetësuesve individual (persona fizik)?

Në rastet e kërkesave për licencim të ndërmjetësuesve si persona fizik, afatet për vlerësim të dokumentacionit dhe kompletim të tij është tridhjetë (30) ditë, kurse afati për të vendosur lidhur me kërkesën për licencim pas kompletimit të dokumentacionit është dyzet e pesë (45) ditë.

53. Cilat kushte duhet të plotësojë në mënyrë që aplikacioni im për licencë të miratohet në BQK?

Varet se për çfarë lloji të ndërmjetësuesit është bere kërkesa për licencim. Nëse kërkohet licencimi si agjent në sigurime duhet te plotësohen kriteret nga neni 4 i Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, nëse kërkohet licencimi si broker në sigurime duhet te plotësohen kriteret nga neni 6 i Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Për kompanitë e agjenteve dhe kompanitë e brokerimit, duhet të plotësohen kriteret nga neni 5, respektivisht neni 7 i Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve. Për më tepër referohuni te Rregullorja për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.

54. A duhet të plotësoj të gjitha kriteret e licencimit?

Po. Si në licencim ashtu edhe në baza të vazhdueshme gjatë zhvillimi të aktivitetit.

Licencimi

55. *Çfarë ndodhë nëse ndonjëra nga informatat e dorëzuara me aplikacion ndryshon gjatë periudhës së vlerësimit të aplikacionit tim në BQK?*

Në rast të ndryshimeve të informatave, aplikuesi për licencë njofton me shkrim BQK-në për faktet ose rrethanat e reja të krijuara. Ky njoftim duhet t'i dërgohet BQK-së menjëherë pasi krijimit të rrethanave të reja, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas paraqitjes së tyre. Nëse ndryshimet që shfaqen gjatë fazës së organizimit ndryshojnë në mënyrë thelbësore ai aplikim mund të refuzohet nga BQK-ja.

56. *Çfarë do të thotë Ekzaminimi i parahapjes?*

Ekzaminimi i para hapjes (tash e tutje EPH) është hapi i fundit i procesit të licencimit të ndërmjetësuesit në sigurime i cili realizohet nga BQK që të përcaktohet se janë plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe të sigurisë të përcaktuara me Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Ekzaminimi realizohet nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim.

57. *A mund të refuzohet aplikimi im?*

Po, BQK mund të refuzojë aplikimi tuaj nëse nuk plotësohen kriteret për licencim. Me rastin e refuzimit, BQK do të ju informojmë me kohë dhe do të jap arsyetimin e bazuar për refuzim.

58. *A mund të apeloj nëse refuzohet kërkesa ime?*

Po, ju mund të apelonit vendimin e BQK. Kundër vendimit të BQK-së ju mund të kërkonit nga Gjykata kompetente që ta shqyrtojë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit, por ushtrimi i ankesës nuk e ndalon zbatimin e vendimit.

59. *A mund të filloj aktivitetet e organizmit para se të licencohem?*

Aplikuesi mund të fillojë me aspektet organizative para se të licencohet nga ana e BQK-së. Megjithatë, puna e ndërmjetësuesit në sigurime nuk mund të fillojë deri sa të jepet licenca.

Ndërmjetësuesit e jashtëm (huaj)

60. *Cili është dallimi në mes të një filiali dhe një dege?*

Filial nënkupton një subjekt të varur të ndërmjetësuesit të huaj, që është nën kontroll të përbashkët me këtë ndërmjetësues, ndërsa degë e ndërmjetësuesit të jashtëm (huaj) nënkupton një subjekt ligjërish të varur të ndërmjetësuesit, i pa themeluar me vete, nëpërmjet të cilit ndërmjetësuesi i jashtëm (huaj) angazhohet në veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime në Republikën e Kosovës. Për më shumë ju lutem referojuni shtojcës IV për Ndërmjetësuesit e jashtëm (huaj) të Manualit për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.